

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-075/12

Prishtinë, 15 Maj 2013

Në çështjen juridike të:

I.M.

Pala ankuese

Kundër

S. P.R.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarja Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vepruar në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA33479) të datës 22 qershor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 15 maj 2013, lëshoi këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa e I. M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011 të datës 22 qershor 2011, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA33479.
- 2- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës të cilat janë në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë Euro) brenda afatit 15 (pesëmbëdhjete) ditore nga data e dorëzimit të aktgjykimit ose përndryshe përmes ekzekutimit të detyrueshëm.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me datën 30 mars 2007 S.P. R. në pozitën e tij si anëtar i bashkësisë familjare ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon njohjen e së drejtës pronësore dhe kthim të posedimit. Ai ka sqaruar se i ati i tij i ndjerë P. S. R. ka qenë pronar i pronës që ndodhet në Svaraçak i Epërm, Vushtrri, ngastra nr. 3381, arë e klasit të 3-të me sipërfaqe prej 91 ari dhe 99 m². Paraqitësi i kërkesës ka theksuar se ngastra ishte humbur më 10 qershor 1999 si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë. Kërkesa ishte regjistruar në AKP me numrin KPA33479.

AKP kishte njoftuar për kërkesën duke e publikuar atë në Gazetën Njoftuese nr. 5 të AKP-së dhe buletin e zyrës për pronën të UNHCR-it. Që të dy publikimet ishin shpërndarë nëpër agjenci të ndryshme publike dhe në Vushtrri. Pasi që askush nuk ishte përgjigjur, AKP e ka proceduar lëndën si të pa-kontestuar.

Me datën 22 qershor 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimin e tij KPCC/D/A/112/2011 ka miratuar kërkesën pasi që paraqitësi i kërkesës e ka vërtetuar se P. S. R. ka qenë pronar i pronës së kërkuar.

Me datën 1 qershor 2012, I.M.(pala ankuese) ka dorëzuar një ankesë në Gjykatën Supreme, ku thekson se vendimi i KKPK-së përmban gabim thelbësor ose zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale ose procedurale. Ai ka shpjeguar se ai nuk ka qenë në dijeni për kërkesën dhe për të është informuar me datën 31 maj 2012 nga AKP-ja. Gjithashtu personi të cilit ai ia kishte shitur ngastrën nuk ishte i njoftuar për kërkesën. Ai pretendonte se ai e kishte blerë ngastrën në vitin 2001

dhe se ia kishte shitur atë G. G. përmes kontratës Nr. 1385/2003. Për të mbështetur pretendimet e tij ai i kishte siguruar Gjykatës Supreme, në mes tjerash, kopjen e kontratës së shitblerjes Vr.Nr. 326/2001 me të cilën ai pretendon se e kishte blerë ngastrën nga S. R. dhe anëtarët e tjerë e familjes R. (gjykata vëren se kopja është e vetëm një pjesë të kontratës, se kopja në shumicën e pjesëve të saj është e palexueshme dhe se nënshkrimet e shitësve janë të palexueshëm për shkak të një njolle të madhe) dhe kopjen e vërtetimit të kontratës në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë (kjo kopje gjithashtu është i një kualiteti shumë të keq dhe pothuajse e palexueshme, gjykata vëren se kopja përmban disa nënshkrime të cilat janë të palexueshme për shkak të njollës e cila duket e ngjashme me njollën në kopje të kontratës). Për më tepër, pala ankuese ka dorëzuar një kontratë të vërtetuar (Vr.nr. 385/2003, Gjykata Komunale në Vushtrri të datës 12 dhjetor 2003) me të cilën ai ia kishte shitur ngastrën nr. 4381 G.G.

Paraqitësi i kërkesës (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) nuk është përgjigjur.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e palejueshme.

Pala ankuese nuk ka interes ligjor për të paraqitur ankesën.

Sipas nenit 2.4 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, e aplikueshme në procedurën para Kolegjit të Apelit të AKP-së së Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 13.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, *“pala duhet të ketë interes ligjor në kërkesë dhe veprimet tjera procedurale që mund të ndërmerren në procedurë”*.

Kjo do të thotë se ankesa mund të paraqitet vetëm nga personi i cili ka interes ligjor në çështjen, nuk mjafton vetëm interesi material.

Pala ankuese, megjithatë, nuk ka interes të tillë ligjor. Sipas deklaratave të tij, ai nuk ka më lidhje ligjore me ngastrën e kontestuar pasi që ai ia ka shitur këtë ngastër G. G. qysh në vitin 2003. Mundësia që G. G. mund t'i kërkoj dëmet nga pala ankuese në rast se bartja e pronës ishte e pavlefshme nuk përbënë interes ligjor por vetëm interes material.

Prandaj, ankesa është dashur të hedhet poshtë si e palejueshme (neni 13.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079; neni 195.1 a) i Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, Neni 8.4 i Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit, (10.21, 10.15 dhe 10.1 i UA 2008/2) pasi që vlera e pronës së kontestuar mund të llogaritet në mënyrë të arsyeshme të jetë € 45.000: € 30.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që humb rastin. Sipas nenit 45.1 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore afati për pagesën e taksës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parashihet që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it